



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE**

MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1, pika 1.3, paragrafi (ç) të Rregullores 2001/19 mbi degën e Ekzekutivit të institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Me qëllim të harmonizimit të akteve nënligjore të MPMS-së me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 12/2007 për unifikimin e pagave/shtesave të kryetarëve/kryesuesve dhe të anëtarëve të Bordeve, Këshillave, e të Komisioneve të themeluara nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës;

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHEZIMIN ADMINISTRATIV NR.09/2007
PER
NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E U.A NR.02/2007 PER ANETARET E
KESHILLIT PER SHERBIME SOCIALE DHE FAMILJARE**

Neni 1

Neni 3 i Udhëzimit Administrativ 02/2007, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin vijues:

Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare, për angazhimet e tyre në këtë Këshill, do të marrin shtesë mujore financiare në lartësi prej:

- a) Kryetari i Këshillit 200 euro
- b) Anëtarët e tjerë të Këshillit 150 euro

Neni 2

Neni 4 i udhëzimit Administrativ nr. 02/2007, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin vijues:

Kompensimet shtesë financiare, anëtarët e Këshillit do t'i realizojnë nga 01.10.2007, datë e cila ndërlidhet me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ nr. 12/2007 nga Qeveria e Kosovës, përmes të cilit rregullohet kompensimi i anëtarëve të Bordeve, Këshilleve dhe Komisioneve të themeluara me Rregullore të UNMIK-ut apo ligje të Kuvendit të Kosovës.

Neni 3

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga 01 tetori 2007.

Prishtinë, tetor 2007

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj
